

# Marrëdhënie partnerësh dhe fëmijët

Partneriteti

Të drejtat dhe detyrat e prindërve

Me qenë prind

Kujdestaria e fëmijëve

Tërheqja e familjes

Konfliktet

## Partneriteti

Në Zvicër janë të akceptuara forma të ndryshme të bashkëjetesës. Për me u martuar, duhet njeriu më s`paku të jetë 18 vjeç. Partnerët në martesë kanë të drejta të barabarta.

### Bashëjetesa

Format e bashkëjetesës janë ndryshuar në dhjetëvjetshin e kaluar shumë. Shpesh jetojnë çifte të pamartuar s`bashku (bashkëjetesë jashtë martesë, Konkubinats) dhe kanë po ashtu fëmijë të përbashkët. Një ndarje të roleve në mes partnerëve (burrë/grua) nuk ka. Edhe bashkëjetesa me gjininë e njëjtë është e akceptuar dhe me ligj e barabartë.

### Martesa / partneriteti i regjistruar

Në Zvicër duhet njeriu të jetë 18 vjeç, për të guxuar të martohet. Edhe çiftet e të njëjtit seks mund të martohen. Kush don të martohet duhet të regjistrohet në Zyrën e gjendjes Civile. Zyra e gjendjes Civile Basel-Landschaft gjendet në Arlesheim dhe ndërmerr një procedurë për parapërgatitjen e martesës. Me këtë shikohet aftësia e partnerëve për martesë. Pas përmbylljes të parapërgatitjeve duhet të bëhet dasma mbrenda tre muajve. Zyra Civile informon saktësisht për procedurën dhe dokumentet e nevojshme. Nëse jeton njëri prej personave jashtë vendit, mundet të bëhet një kërkesë për ardhje për përgatitjen e martesës. Nëse dyshohet për një martesë të falsifikuar, zyra e gjendjes civile mund të refuzojë ceremoninë e martesës. Në këtë rast, edhe një martesë e lidhur tashmë mund të shpallet e pavlefshme ose të hiqet leja e qëndrimit.

### Të drejtat dhe detyrimet

Partnerët në martesë sipas ligjit kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime dhe janë të barabartë. Të dy partnerët bashkëshortor duhet të martohen me dëshirë. Nëse zyrtarët e kuptojnë, se dikush është detyruar të martohet (Zwangsheirat), munden këtë martesë ta shpallin të pavlefshme dhe atë i cili e ka detyruar këtë martesë ta dënojnë. Kush ndjehet se është detyruar për një martesë, duhet të kërkoj mbështetje. Për këtë është numri i telefonit pa pagesë (0800 800 007) nga Qendra Këshillimore për martesat e detyruara [zwangsheirat.ch](http://zwangsheirat.ch).

## Planifikimi familjar

Për pyetje për planifikimin familjar, shtatzënesinë dhe seksualitetin ka në kantonin Basel-Landschaft qendra speciale këshilluese në Liestal dhe Binningen. Këto vende informojnë pjesërisht falas dhe me besim për temat si mbrojtja, problemet seksuale, shtatzënesit e pa dëshiruara apo sëmundjet e organeve gjenitale. Ato këshillojnë edhe prindërit e ardhshëm dhe personat me fëmijë.

## çkurorëzimi

çkurorëzimi mundet s` bashku prej të dy bashkëshortëve apo edhe vetëm prej njërit bashkëshort të kërkohet. Përgjegjës janë gjykatat civile të rretheve (Zivilkreisgerichte) i rrethit. Edhe bashkëshortësit të cilat janë bërë jashtë vendit munden sipas të drejtës Zvicerane të shkurorëzohen. Për këtë duhet njeriu që qëllimin për jetë ta ketë në Zvicër dhe më s` paku të ketë një vit me banim këtu. Një shkurorëzim mund të ketë ndikim te leja e qëndrimit, apo te procedura për nënshtetësi. Se a munden personat e huaj mbas shkurorëzimit të rrin në Zvicër, mvaret prej shumë faktorëve. Për viktimat e dhunës familjare vlejnjë rregulla të posaçme. Informacione për shkurorëzim mundet njeriu me marr në këshillimore për familje dhe bashkëshortësi apo këshillimore për të drejta.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/partneriteti](http://www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/partneriteti)

## Të drejat dhe detyrat e prindërve

Kush ka një fëmijë, duhet menjëherë ta lajmëroj lindjen në zyrën civile. Te çiftet e martuara është e drejta e përkatësis të fëmijut automatikisht e rregulluar, çiftet e pa martuara duhet për këtë vet të përkujesin.

### Lajmërimi i lindjes

Lindja e çdo fëmiju duhet të lajmërohet në Zyrën Civile (Zivilstandsamt). Kujdes: Se cila zyrë e gjendjes civile është përgjegjëse mvarret prej vendit të lindjes dhe jo prej vendbanimit të prindërve. Nëse lindja bëhet në një spital, i dërgon spitali dokumentet në zyrën e gjendjes civile përgjegjëse. Nëse lindja nuk bëhet në një spital ( por p.sh. në shtëpi), duhet që lindja të lajmërohet vet brenda tri ditësh. Zyra e gjendjes civile përgjegjëse informon, cilat dokumente janë të nevojshme. Fëmijët e lindur në Zvicër nuk marrin automatikisht nënshtetësin Zvicerane.

### Njohja e atësis

Kur çiftet e martura kanë një fëmijë, bashkëshorti njihet automatikisht si baba. Nëse bashkëshorti dyshon që është baba, mundet me gjyq ta inicioj vërtetimin e atësisë. Kur prindërit nuk janë të martuar, babi i fëmijës nuk regjistrohet automatikisht si baba. Ai mundet fëmijën ta pranoj para ose pas lindjes në komunën që banon te zyra e gjendjes civile. Nëse nuk don babai ta pranoj fëmijën e tij mundet nëna para gjyqit ta kërkoj që ai ta pranoj fëmijën e tij.

### Përkujdesja prindërore

Prindërit kanë të drejta dhe detyrime, për mirëqenjen e fëmijëve (elterliche Sorge). Këtu përkujdesja përfshijë edukimi, apo përkujdesja financiare. Prindërit përfaqësojnë fëmijët e tyre me ligj deri ata të bëhen 18 vjeç. Nëse prindërit janë të martuar i kanë automatikisht të drejtat dhe detyrimet e njëjta përkundrejt fëmijut. Nëse nuk janë të martuar duhet babai më parë ta pranoj fëmijun. Pastaj munden prindërit ta bëjnë vullnetarisht një sqarim me shkrim për përkujdesjen prindërore të përbashkët (gemeinsame elterliche Sorge). Këtë e bëjnë njeriu ose së bashku me pranimin e fëmijut te zyra e gjendjes civile apo më vonë te zyrtarët për mbrojtjen e fëmijëve (Kindesschutzbehörde, KESB) të rrethit. Nëse prindërit e pa martuar nuk janë të një mendimi për të drejtën për përkujdesje ndaj fëmijut, vendosin zyrtarët për mbrojtjen e fëmijëve. Kush ka pyetje apo i nevojitet mbështetje, drejtohet në një qendër përkatëse për këshillim.

## **Mbajtja**

Kur prindërit ndahen, janë ata edhe më tutje të detyruar, të përkujdesen për fëmijën (Unterhalt). Ata duhet për këtë mbajtjen financiare dhe përkujdesjen për fëmijë ta rregullojnë me njëri tjetrin. Pagesa për mbajtje ndahet në mes babait dhe nënës. A dhe sa njëri prind duhet të paguaj, mvaret prej situatës ekonomike dhe pjesëmarrjen e tij për përkujdesjen për fëmijun. Nëse nuk është e mundur një marrveshje, mundet njeriu të shkojë para gjyqit. Nëse nuk paguan partneri i detyruar për këtë, mundet njeriu në komunën ku banon të kërkojë ndihmë. Kjo mbështetë, që shumën e caktuar ta kërkojë dhe/apo cakton një shumë për mbajtje, nëse njëri nga partnerët ka të drejtë për këtë (Alimentenbevorschussung).

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/te-drejat-dhe-detyrat-e-prinderve](http://www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/te-drejat-dhe-detyrat-e-prinderve)

## Me qenë prind

Me e edukuar një fëmijë, është me shumë përgjegjësi. Shumë prindër bëjnë aty këtu ndonjë pyetje, çka është e mirë për fëmijun e tyre. Shkëmbimi me prindërit e tjerë mund të jetë shumë i dobishëm. Përveç kësaj ka qendra të ndryshme për këshillim të cilat ndihmojnë.

### Pikëtakimet

Ka oferta të shumta për nëna dhe baba, që duan të shkëmbehen me prindërit e tjerë apo që duan me fëmijën e tyre të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme. Disa oferta janë bërë posaçërisht, që prindërit zviceran dhe ata të huaj të ndëlidhin kontakte.

- Për foshnja dhe fëmijë të vegjël deri në 2 vjeç ka në shumë komuna grupet e zvarritjes (krabbelgruppen), ku edhe prindërit vin në kontakt me njëri tjetrin.
- Prindërit-fëmijë-educatë fizike (MuKi-/VaKi-/EIKi-educatë fizike) ofron lojë, kënaqësi dhe lëvizje për prindër me fëmijë të vegjël. Edukata fizike ofrohet në shumicën e komunave.
- Në qendrat familjare (Familienzentrum) bëhen gjëra të ndryshme për prindër dhe fëmijët e tyre.
- Bibliotekat dhe ludotekat kanë oferta për fëmijë të vegjël dhe të mëdhenjë dhe prindërit e tyre.

E vlen gjithsesi, që të njoftoheni te komuna që banoni mbi ofertat e ndryshme në rajon.

### Arsimimi për prindër

Në kantonin Basel-Landschaft munden prindërit që të bëjnë kurse për tema të ndryshme. Ka kurse, që posaçërisht përbushin nevojat e emigranteve dhe emigrantëve. Kështu ka shembull kurse për sistemin shkollor zviceran. Disa kurse ofrohen edhe në gjuhë të huaja. Mbi ofertat informojnë faqet e internetit " Elternbildung Baselland", shkollat apo vendbanimi komunal.

### Këshillimi për edukim

Kush ka pyetje për edukim të fëmijëve, mundet të drejtohet në këshillimore të ndryshme. Në të gjitha rajonet ka këshillimore për familje. Mëtej ofrojnë këshillimoret për nëna dhe baba (Mütter-und Väaterberatung) në komuna të ndryshme, ndihmën e tyre, po ashtu në pyetjet për përkujdesje ndaj foshnjave. Te thirrjet urgjente të prindëve këshillojnë specialistët prindërit në telefon apo me E-Mail (telefoni 0848 35 45 55 (tarifa me telefon fiks), [www.elternnotruf.ch](http://www.elternnotruf.ch)).

**Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/me-qene-prind](http://www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/me-qene-prind)

## Kujdestaria e fëmijëve

Shumë baba dhe nëna punojnë edhe pas lindjes të fëmijut. Për këtë ka në kantonin Basel-Landschaft oferta speciale për kujdestari të fëmijëve. Shumica janë me para.

### Qëndrim ditor për fëmijë (KITA)

Në çerdhët për fëmijë (Kinderkrippen) fëmijët kanë tërë ditën kujdestari. Shumica e ofertave janë për fëmijë 3 muajsh deri në moshën shkollë. Disa çerdhe për qëndrim ditor të fëmijëve ofrojnë kujdestari për fëmijë shkollor (para dhe pas shkollës edhe përgjatë drekës). Meqë listat e pritjes të shumtën janë të gjata, duhet prindërit fëmijën e tyre ta paraqesin shumë herët. Shpenzimet janë të ndryshme në çerdhet ditore të fëmijëve dhe pjesërisht i bartin komunat. Vendet e qëndrimit ditor të fëmijëve apo të vendbanimit të komunës informojnë për mundësit e paraqitjes dhe shpenzimet.

### Grupet për lojë

Shumë fëmijë vizitojnë para hyrjes në shkollë një grup për lojë (Spielgruppe). Aty takohen fëmijët prej për afërsisht 3 vjet pa prindërit e tyre, për me luajt me krijuar etj. me kujdestare të shkolluara. Vizita në grupet e lojës është vullnetare. Për fëmijë që nuk flasin në shtëpi gjermanisht, është grupi për lojë një mundësi me ardhë kontakt me gjuhën gjermane. Kjo e lehtëson hyrjen në shkollë. Shpenzimet janë të ndryshme dhe pjesërisht i bartë vendbanimi komunal. Grupe për lojë ka pothuajse në çdo komunë, komuna informon mbi mundësin për paraqitje dhe shpenzimet.

### Struktura ditore / dreka

Pjesërisht ofrojnë shkollat kujdestari jashtë mësimi. Në shkollat me strukturë ditore (Tagesstruktur) munden fëmijët shkollor gjatë drekës të qëndrojnë në shkollë. Ata e kanë një drekë. Mas shkollës munden nën kujdestari t`i kryejn detyrat e shtëpisë. Këto oferta duhet të paguhen nga prindërit. Tarifat janë shpesh të mvarura nga të ardhurat e prindërve. Fëmiju mund të përfitoj nga kjo ofertë një apo më shumë ditë. Struktura ditore nuk duhet të ngatërrohet me shkollat ditore (Tagesschulen), ku fëmijët pesë ditë në javë në gjithë programin ditor duhet të marrin pjesë.

### Familjet ditore

Familjet ditore (Tagesfamilien) janë familje, që fëmijët përgjatë një kohe të caktuar ditore (të shumtën tërë ditën) t`i marrin pranë vetes. Kjo ofertë për kujdestari të fëmijëve është te prindërit në marrdhënie pune shumë e kërkuar. Ka vende ndërmjetësuese, që gjatë kërkimit të një familje ditore ndihmojnë dhe informojnë mbi tarifin.



## **Kujdestare për foshnje / Situatat urgjente**

Në Zvicër angazhohen shpesh të rinjët si kujdestarë të foshnjave në mbrëmje apo në fundjavë. Kryqi i Kuq Zviceran (SRK) Baselland udhëheq një listë me vende ndërmjetësuese me kujdestar për foshnja të cilët e kanë bërë një kurs. Është e natyrshme që të rinjët të paguhen. Në raste të paparashikuara urgjente ofron Kryqi i Kuq Zviceran (SRK) Baselland përkujdesje për fëmijë. Shembull kur njëri prind duhet të shkoj në spital dhe askush tjetër nuk mund të përkujdeset për fëmijun. Kujdestaria kushton, disa sigurime shëndetësore i mbulojnë shpenzimet.

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/kujdestaria-e-femijev](http://www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/kujdestaria-e-femijev)  
e

## Tërheqja e familjes

Anëtarët e familjes të personave, të cilët jetojnë në Zvicër, mundën sipas rrethanave të vijnë në Zvicër. Kur të afërmit dhe të njofshmit dëshirojnë të vijnë në Zvicër, duhet të aplikojnë sipas vendit që vijnë për një vizë vizite.

### Tërheqja e familjes

Parimisht ekziston mundësia, që edhe antarët familjar (të afërmit direkt apo partneri bashkëshortor) prej personit që jeton këtu të vijnë në Zvicër (tërheqja e familjes, Familiennachzug). Për cilët antarë të familjes mund të aplikohet, mvaret prej përkatsisë shtetërore dhe leje qëndrimit të aplikuesit për kërkesë. Edhe personat me një qëndrim kalues (letërnjoftim F) mundën sipas rrethanave ta tërheqin familjen e tyre. Zyra për Migrimin dhe të Drejtat e Qytetarëve (Amt für Migration und Bürgerrecht) vendos për kërkesën dhe jep informacione për dokumentet e nevojshme dhe ecurin e saktë të procedurës. Kujdes: Tërheqja e familjes duhet mbrenda një kohe të caktuar të procedohet. Kjo është te fëmijët më e shkurtër se te personat e rritur (p.sh. partneri i bashkëshortësisë).

### Parapërgatitja për martesë

Kush banon në Zvicër dhe dëshiron ta martoj një partnere apo partner që vie nga jashtë, mundet për parapërgatitje të martesës ta bëjë një kërkesë për ardhje (Vorbereitung der Heirat). Kjo leje ju mundëson partnerës apo partnerit, që para martesës të vijnë në Zvicër dhe të martohen këtu. Zyra për Migrimin dhe të Drejtat e Qytetarëve (Amt für Migration und Bürgerrecht) e kantonit vendos për kërkesën dhe njofton për dokumentet e nevojshme dhe ecurin e saktë të procedurës.

### Viza e udhëtimit

Për banoret dhe banorët e shumë vendeve nuk është e thjeshtë, që ta marrin një vizë udhëtimi për në Zvicër, shembull për të vizituar të afërmit. Mundet me qenë, që prej personave që jetojnë këtu të kërkohet të bëjnë një ftesë me shkrim dhe një garantim të detyruar (Verpflichtungserklärung). Përfaqësit Zvicerane jashtë vendit vendosin për kërkesën dhe njofton për dokumentet e nevojshme dhe ecurin e saktë të procedurës. Informacionet mund të merren edhe te zyra për Migrim dhe Integrim (Amt für Migration und Integration) të kantonit.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/terheqja-e-familjes](http://www.hallo-baselland.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/terheqja-e-familjes)

## Konfliktet

Te konfliktet në partneritet apo familje ndihmojnë qendra të ndryshme këshilluese. Dhuna në familje apo bashkëshortësi është e ndaluar.

### Konfliktet në marrdhënie të partnerëve

Kur te partnerët vie deri te konfliktet, munden partnerët të marrin ndihmë profesionale (Eheberatung). Këshillimoret speciale ju ndihmojnë ju, të gjeni zgjidhje. Bisedat e para janë zakonisht falas apo të liruara. Në çdo rajon ka për këtë një këshillimore përgjegjëse.

### Konfliktet në familje

Në familjet me fëmijë mundet nganjëherë me ardhë në situata të vështira, të cilat për prindër e fëmijë munden me qenë të besdizshme. Është në çdo rast të propozohet, që prindërit të marrin ndihmë, kur nuk din më si t`ia bëjnë tutje. Te këshillimoret për familje (Familienberatungsstelle) mundet njeriu personalisht të këshillohet. Në thirrjen urgjente për prindër (Elternnotruf) këshillojnë njerëzit specialist në telefon apo në Mail, gjatë pyetjeve për edukim apo kur keni brenga për fëmijun tuaj (telefoni 0848 35 45 55 ( falas, [www.elternnotruf.ch](http://www.elternnotruf.ch)). Fëmijët dhe të rinjët munden përmes telefonit, mail, sms apo chat në thirrjen urgjente për fëmijë (Kindernotruf) të thërrasin (telefoni 147 (kostenlos), [www.147.ch](http://www.147.ch)).

### Dhuna shtëpiake

Dhuna në familje është një delikt zyrtar. Kush ushtron dhunë, e bënë veten të dënueshëm- pavarësisht nga pesha e dhunës. Nuk ka rëndësi, a është dhuna kundrejt partnerës, partnerit në martesë apo fëmijëve e drejtuar. Zyrtarët duhet të bëhen aktiv, kur të kuptojnë për dhunën në familje. Për viktimat të dhunës ka oferta me besim mbështetëse falas. Në banime speciale (Frauenhaus / Väterhaus) munden gratë apo burrat s`bashku me fëmijët e tyre përkohësisht të kërkojnë mbrojtje. Në shtëpinë e grave munden gratë e goditura nga dhuna përgjatë gjithë kohës të telefonojnë (telefoni 061 681 66 33). Fëmijët dhe të rinjët munden në thirrje urgjente për fëmijë (Kindernotruf) të thërrasin (telefoni 147 (falas), [www.147.ch](http://www.147.ch)). Kush ndihet i kërcënuar nga një antarë i familjes, duhet ta thërras policinë (telefoni 117). Këta munden që një person, që ushtron dhunë apo kërcënohet të ushtroj dhunë, për një kohë të gjatë ta largoj prej banesë apo shtëpie.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/marrredhenie-partneresh-dhe-femijet/konfliktet](http://www.hallo-baselland.ch/sq/marrredhenie-partneresh-dhe-femijet/konfliktet)